



RADIOTELEVISIONI I KOSOVËS
RADIO TELEVISIONI I KOSOVA
RADIO TELEVISION OF KOSOVO

REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIC OF KOSOVO ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT NATIONAL AUDIT OFFICE			
DATA E BASHKËPISËMËRIMIT DATE OF SIGNATURE		4 07. 2022	
Nr. i Dokumentit Doc. No.	Nr. i Aktit Act No.	Nr. i Protokollit Prot. No.	Nr. i Raportit Rep. No.
05	47	1144	9

Plani i veprimit për zbatimin e rekomandimeve të Zyrës Kombëtare të Auditimit

Menaxhmenti i Radiotelevizionit të Kosovës (RTK) ka hartuar një plan të veprimit për zbatimin e gjetjeve dhe rekomandimeve të raportit të Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZKA), pas auditimit të Pasqyrave Financiare të RTK-së për vitin 2021.

Në këtë raport, Zyra Kombëtare e Auditimit (ZKA) ka rekomanduar Bordin e RTK-së që ta dorëzojë një plan të veprimit për zbatimin e rekomandimeve, i cili ka për qëllim forcimin e kontrollit të brendshëm dhe përmirësimin e menaxhimit financiar të RTK-së.

Bordi i RTK-së poashtu është rekomanduar që të marrë në konsideratë sesi do të mund të i forcojë përgjegjësitë e veta mbikëqyrëse.

Nga ZKA është kërkuar që një plan i tillë t'i prezantohet deri në fund të muajit qershor 2022, dhe një raport i veçantë mbi zbatimin e këtij plani t'i dorëzohet ZKA-së jo më vonë se më 31 Tetor 2022.

Nisur nga këto, Menaxhmenti i RTK-së ka përgatitur planin aksional për Bordin e RTK-së, i cili pritet të miratohet dhe të fillojë të zbatohet, ashtu sikurse është kërkuar në raportin e ZKA-së, për çështjet dhe rekomandimet si në vijim:

Çështja A1 - Trajtimi i të hyrave jo në pajtim me Standardin e Raportimit Financiar

Rekomandimi A1 Bordi i RTK-së të sigurojë se të gjitha transaksionet të cilat kryen gjatë periudhës kontabël të trajtohen sipas kërkesave të Standardeve Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK) dhe Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF), në mënyrë që raportimi financiar të jetë i drejtë dhe në pajtim me kornizën raportuese.

Plani i veprimit:

1. Menaxhmenti i RTK-së, duke u bazuar në një vendim të Bordit, që prej muajit janar 2022, nuk është nënshkruar marrëveshje të reja për të siguruar të hyra nga marketingu me kompensim deri në vendimin e radhës.
2. Janë duke u vazhduar vetëm kontratat aktuale dhe të trashëguara me kompensim deri në përfundimin e afatit kohor të paraparë në kontratat në fjalë.
3. Në bazë të rekomandimeve dhe me qëllim të përmirësimit të procedurave, do të përpilohet një udhëzues sipas Standardit të Raportimit Financiar, i cili do të saktësonte procedurat të cilat do të zbatohen nga të gjitha palët, që kanë të bëjnë me kompetencat

dhe autorizimet përkitazi me çështjet vendimmarrëse për kompensimin me marketingun e RTK-së. Ky udhëzues do të miratohet nga Bordi.

Çështja A2 - Mungesa e konfirmimeve nga palët e treta për llogaritë e pagueshme

Rekomandimi A2 Bordi i RTK-së duhet të sigurojë se janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme për harmonizimin vjetor të gjendjes së llogarive mes RTK-së dhe furnitorëve, duke mos i përjashtuar edhe dërgesat fizike të konfirmimeve nga zyrtarët e RTK-së dhe vizitave te furnitorët për ta konfirmuar gjendjen përfundimtare të detyrimeve.

Plani i veprimit:

1. Menaxhmenti i RTK-së do të shqyrtojë dhe merr vendim për angazhimin e një komisioni te brendshëm (që pritet të kryesohet nga Zyra Ligjore e RTK-së) i cili do të bëjë një analizë dhe barazim të borxheve të vjetra.
2. Menaxhmenti do të themelojë ekipën e Task Forcës, që do të punojë ngushtë me komisionin e brendshëm për çështjen e lartëshënuar; të bëjë një strategji për zgjidhjen e çështjes e borxheve në fjalë si:
 - a) zhvillimin e negociatave për borxhet e mbetura
 - b) afatet e pagesave të borxheve
 - c) provizionimin e borxheve
 - d) shlyerjen e borxheve.
3. Raporti përfundimtar do të miratohet nga Bordi i RTK-së.

Çështja A3 - Aplikim i politikave të pa qarta për vlerësimet kontabël

Rekomandimi A3 - Bordi i RTK-së të sigurojë se janë marrë veprime konkrete për përcaktimin e politikave të qarta të vlerësimeve kontabël, sidomos të pasurive të paprekshme. Sugjerojmë se me rastin e vlerësimeve që një produksion të trajtohet si pasuri apo të njihet si shpenzim i periudhës, RTK të formojë një juri kompetente e cila do ta vlerësonte cilësinë, vlerën e produksionit dhe jetëgjatësinë e tij, dhe varësisht nga këto vlerësime, të bëjë edhe regjistrimet kontabël.

Plani i veprimit:

1. Menaxhmenti i RTK-së do të marrë veprime konkrete për përcaktimin e politikave të qarta të vlerësimeve kontabël, veçmas të pasurive të paprekshme.
2. Menaxhmenti i RTK-së do të formojë një juri kompetente e cila do ta vlerësonte cilësinë, vlerën e produksionit dhe jetëgjatësinë e tij me rastin e vlerësimeve që një produksion të trajtohet si pasuri apo të njihet si shpenzim i periudhës.

3. Menaxhmenti i RTK-së ka angazhuar menaxherin e kostos, që nga data 06 Maj 2022, që do të bëjë vlerësimet e kostove dhe kontrollojë menaxherët e kontratave, të cilët do të ofrojnë shënime të sakta për shkallën e përmbushjes së kontratës. Varësisht nga këto vlerësime do të ofrojnë shënime të sakta për regjistrimet kontabël.

Cështja A4 – Nënvlërësimi i investimeve në vijim/të drejtat e programit

Rekomandimi A4- Bordi i RTK-së duhet të siguroj se para përgatitjes së pasqyrave financiare, të gjitha transaksionet të cilat kanë ndodhur janë paraqitur drejtë dhe saktë në periudhën e duhur kontabël. Po ashtu, menaxherët e kontratave deri në datën raportuese duhet të ofrojnë shënime të sakta për shkallën e përmbushjes së kontratave.

Plani i veprimit:

1. Menaxhmenti i RTK-së ka angazhuar menaxherin e kostos që duke filluar nga data 06 Maj 2022 që t'i bëjë vlerësimet e kostove dhe t'i kontrollojë menaxheret e kontratave, të cilët do të ofrojnë shënime të sakta për shkallën e përmbushjes së kontratës.

Cështja A5 – Mbi pagesa për shujtë

Rekomandimi A5- Bordi i RTK-së duhet të siguroj se pagesat për shujta iu bëhen vetëm personave të cilëve u takon ky kompensim sipas rregulloreve.

- **Plani i veprimit:**

Evidentimi i stafit në punë dhe pagesa e shujtës konform pranisë në punë është trajtuar dhe zbatuar me prioritet. Së fundmi, RTK është në proces të zbatimit të këtij rekomandimi me kompaninë e specializuar për lidhjen automatike të sistemit të evidentimeve të hyrje-daljeve me shujtën, e cila do të ndikonte pozitivisht në procesin evidentimit të pranisë në punë dhe kalkulimit të shujtave. Sipas kompanisë së autorizuar, zbatimi i këtij sistemi automatik do të nis në fund të muajit Korrik ose Gusht 2022.

Çështja A6 – Kompensimi i llogarive në mes RTK dhe Telekomit të Kosovës

Rekomandimi A6- Bordi i RTK-së të sigurojë se në të ardhmen nuk do të ndiqen praktika të tilla dhe të merren veprime korigjuese, në mënyrë që prezantimi i informacionit financiar të jetë i plotë dhe konform standardeve ndërkombëtare të raportimit financiar

Plani i veprimit:

RTK do të angazhohet maksimalisht për ta trajtuar këtë çështje në detaje dhe për të gjetur rrugën dhe zgjidhjen më të mirë, duke respektuar legjislacionin në fuqi. Komiteti i Auditimit bashkë me ZKF-në janë duke shqyrtuar të gjithë dokumentacionin lidhur me këtë rast.

Çështja A7 – Mungesë evidencash për vijueshmërinë e stafit në punë

Rekomandimi A7- Bordi i RTK-së duhet të sigurojë se menaxhmenti nxjerrë vendime në harmoni me rregullativën ligjore. Po ashtu, duhet të vendos kontrole më efektive për vijueshmërinë e gjithë stafit, si dhe të pajisë gjithë stafin me kartela, për të bërë të mundur evidentimin e vijueshmërisë së tyre në punë apo mbajtjen e evidencave në forma tjera.

Plani i veprimit:

Më 04.03.2022 është shfuqizuar vendimi me numër protokolli 2501/16 i datës 15.08.2016 në bazë të të cilit liroheshin nga evidentimi ditor i pranisë në punë disa kategori të caktuara të punëtorëve. Po të njëjtën datë, më 04.03.2022 është marr vendim i ri me numër të protokollit 0862/22, që i obligon të gjithë të punësuarit të evidentohen në baza ditore për praninë në punë.

Në mungesë të ID kartelave, për një periudhë të caktuar, është përgatitur lista e veçantë fizike për evidentim në portë (hyrje-dalje). Ndërkohë janë siguruar ID kartelat dhe është

kërkuar nga i gjithë stafi i RTK-së që të pajiset me ID karta dhe të evidentohet në sistemin elektronik për praninë në punë.

Rrjedhimisht është ngritur vetëdijësimi dhe është rritur prania e stafit në vendin e punës. Kjo ka rezultuar me fillim të rritjes së numrit të kërkesave për arsyetim të pushimeve vjetore, mjekësore apo pushimeve pa pagesë.

Cështja A8 – Mungesa e konfirmimeve nga palët e treta për llogaritë e arkëtueshme

Rekomandimi A8- Bordi i RTK-së duhet të sigurojë se janë marrë të gjitha veprimet e nevojshme për harmonizimin vjetor të gjendjes së llogarive mes RTK-së dhe debitorëve, duke mos i përjashtuar edhe dërgesat fizike të konfirmimeve nga zyrtarët e RTK-së dhe vizitave te debitorët për ta konfirmuar gjendjen përfundimtare të kërkesave

Plani i veprimit:

1. Në mbledhjen e datës 13 Maj 2022, Menaxhmenti i RTK-së ka formuar një Task Forcë për llogaritë e arkëtueshme nga marketingu që do të bëjë një analizë dhe barazim të llogarive të vjetra të arkëtueshme.

2. Menaxhmenti do të formojë edhe një Task Force për llogaritë e tjera të arkëtueshme, që do të punojë ngushtë me Task Forcën paraprake dhe të bëjë një strategji për zgjidhjen e çështjes së të gjitha llogarive të arkëtueshme në fjalë si:

- a) zhvillimin e negociatave lidhur me llogaritë e arkëtueshme të mbetura
- b) afatet e pagesave të llogarive të arkëtueshme
- c) provizionimin e llogarive të arkëtueshme duke përfshirë
- d) shlyerjen e llogarive të arkëtueshme.

3. Raporti përfundimtar do të shqyrtohet në Menaxhment dhe do të miratohet në Bord.

Cështja A9 – Mos zbatimi i vendimit për ndalesat e shpërblimeve dhe shtesave

Rekomandimi A9- Bordi i RTK-së duhet të sigurojë se vendimet e tij janë duke u zbatuar nga menaxhmenti. Po ashtu, duhet të sigurojë se për të gjitha pagesat për shpërblime apo shtesa të paguara jashtë vendimeve, rregullësia e tyre do të shqyrtohet nga ana e Departamentit Ligjor.

Plani i veprimit:

Të gjitha vendimet e bordit të RTK-së dhe të Menaxhmentit janë duke u zbatuar në tërësi përfshirë edhe vendimin me numër 0125/22 të datës 07.06.2022 për shfuqizimin e pikës 2 të vendimit/ rekomandimit të Bordit të RTK-së, të datës 22.01.2019.

Çështja A10 – Mos dhënia e informacioneve shpjeguese për kontingjencat

Rekomandimi A10- Bordi i RTK-së të sigurojë, se ngjarjet të cilat i plotësojnë kushtet për trajtimin e tyre si detyrime kontingjente, të analizohen dhe vlerësohen në detaje në mënyrë që të njihen provizionet e këtyre llogarive

Plani i veprimit:

1. Menaxhmenti i RTK-së ka udhëzuar Zyrën Ligjore që të bëjë vlerësimin e detyrimeve dhe kërkesave kontingjente të RTK-së.
2. Zyra Ligjore ka hartuar tashmë një raport të detajuar për trajtimin e detyrimeve dhe kërkesave kontingjente si:
 - a) provizionimin e kontingjencave dhe
 - b) shpalosjen e kontingjencave.
3. Raporti përfundimtar do të miratohet në Menaxhment.

Çështja A11 – Trajtim kontabël jo adekuat i investimit në vijim

Rekomandimi A11- Bordi i RTK-së të sigurojë se në pamundësi të realizimit të projektit, të bëhen vlerësimet dhe korrigjimet e nevojshme kontabël dhe trajtimi i duhur i këtij zëri në pasqyrat financiare

Plani i veprimit:

RTK-ja do të angazhohet maksimalisht për ta trajtuar këtë çështje në detaje dhe për të gjetur rrugën dhe zgjidhjen më të mirë, duke respektuar legjislacionin në fuqi. Komiteti i Auditimit bashkë me ZKF-në janë duke shqyrtuar të gjithë dokumentacionin lidhur me këtë rast. Nga ajo çka kemi analizuar deri më tani rezulton se në këtë çështje duhet të përfshihet prokuroria, e cila do të njoftohet së shpejti me rastin dhe ne do të jemi të kujdesshëm në trajtimin e këtij rasti, duke mos marrë ndonjë veprim që mund të pengojë hetimet.

Cështja A12 – Pronësia e pa definuar e pasurive /objekteve ku operon RTK

Rekomandimi A12- Bordi i RTK-së duhet të merr masa të menjëhershme dhe çështjen e këtij objekti ta diskutojë me Kuvendin e Kosovës dhe AKP-në në mënyrë që të sqarohet pronësia e përhershme apo dhënia në shfrytëzim për kohë të caktuar, dhe më pas, çështja të trajtohet edhe në aspektin kontabël të regjistrimit të saj.

Plani i veprimit:

1. Më datë 26.05.2022, menaxhmenti i RTK-së ka formuar një grup punues për përcaktimin e çështjes së pronës së RTK-së.
2. Grupi punues do ta përpilojë një raport të detajuar bazuar në dokumentet e gjetura për pronën e RTK-së.
3. Raporti do të shqyrtohet në menaxhment, bord dhe do t'i dorëzohet themeluesit, Kuvendit të Kosovës.

Cështja A13 – Ndarje jo e duhur e detyrave në proceset e prokurimit dhe mos respektim i kërkesave teknike dhe profesionale të operatorëve

Rekomandimi A13- Bordi i RTK-së të sigurojë se departamenti i prokurimit i zbaton me konsistencë të gjitha kërkesat e rregulloreve të prokurimit dhe do të eliminoj të gjitha lëshimet e identifikuara në rastet e identifikuara më lartë.

Plani i veprimit:

Plani i veprimit

1. Menaxhmenti ka udhëzuar Departamentin e Prokurimit që menjëherë të zbatohet rekomandimi i ZKA-së për respektimin e kërkesave teknike dhe profesionale të operatorëve dhe t'i eliminoj të gjitha lëshimet e identifikuara.
Ky rekomandim është duke u zbatuar tashmë.

Cështja A14 – Procesimi jo i plotë i pasurive përmes softuerit të kontabilitetit

Rekomandimi A14- Bordi i RTK-së të sigurojë se menaxhimi i pasurisë së paprekshme dhe stokeve të bëhet përmes një moduli të integruar, në të cilin zyrtari i pasurisë në çdo kohë ka qasje të plotë në të gjitha pasuritë dhe menaxhimin e tyre, si dhe gjendja e stokeve të vendoset nën një kontroll më efikas.

Plani i veprimit:

1. Më datë 26.05.2022, Menaxhmenti ka vendosur që të shpall tender për një modul të ri të stokeve.

2. Përfaqësuesi kompetent i mirëmbajtjes së modulit të pasurisë do të aplikojë një modul gjithëpërfshirës të menaxhimit të pasurisë së RTK-së.

3. Zyra e pasurisë së RTK-së do të sigurojë se menaxhimi i pasurisë së paprekshme dhe stokeve do të bëhet përmes një moduli të integruar, në të cilin zyrtari i pasurisë, në çdo kohë, do të ketë qasje të plotë në të gjitha pasuritë dhe menaxhimin e tyre teksa gjendja e stokeve do të vendoset në një kontroll më efikas.

Cështja A15 – Mos funksionimi i njësisë së monitorimit në marketing

Rekomandimi A15- Bordi i RTK-së të sigurojë se do të merren veprime konkrete për evidentimin dhe rregullimin e problemeve tek njësia monitorimit në marketing, në mënyrë që ky softuer të përmirësohet dhe funksionalizohet plotësisht.

Plani i veprimit:

1. Në bashkëpunim me njësinë e IT-së dhe menaxhmentit, janë ndërmarr hapa urgjent që përfshijnë sigurimin e të ashtuquajturës: CAPTURE SEVER në dy pjesë. Kjo mundëson monitorimin e të hyrave nga marketingu në formë të rregullt.

Cështja A16 – Dobësi në raportim të progresit të kontratave nga menaxherët

Rekomandimi A16- Bordi i RTK-së duhet të siguroj se janë vendosur kontrolle adekuate sa i takon menaxhimit të kontratave, në mënyrë që raportimi i progresit të kontratave të jetë me kohë dhe i saktë.

Plani i veprimit:

1. Menaxhmenti i RTK-së ka angazhuar një menaxhere të kostos, e cila prej datës 05 Maj 2022 do t'i bëjë vlerësimet e kostove dhe do t'i kontrollojë menaxherët e kontratave, të cilët do të ofrojnë shënimet e sakta për shkallën e përmbushjes së kontratës.

Çështja A17 – Mos funksionimi i Komitetit të Auditimit

Rekomandimi A17- Bordi i RTK-së të siguroj së emërimi i anëtarëve të komitetit të auditimit të brendshëm duhet të ketë së paku dy të tretat e anëtarëve të jashtëm sipas kërkesave të Ligjit për kontrollin e brendshëm të financave publike.

Plani i veprimit:

1. Rekomandimi A17 është përmbushur plotësisht. Sipas ligjit nr. 06/L-021, janë emëruar 3 anëtarë të komitetit të auditimit të RTK-së, dy (2) prej tyre anëtarë të jashtëm dhe një (1) anëtar i brendshëm.